



Mësimi në gjuhën e prejardhjes (amtare) (Heimatliche Sprache und Kultur HSK)

Informacione për prindër dhe për ata të cilët kanë të drejtë edukimi

Mbështetja gjatë mëimit të gjuhës gjermane dhe zhvillimi i kompetencave intelektuale të shumë gjuhëve i takojnë thelbësisht detyrave të arsimit në shkollat publike. Zhvillimi i të mësuarit të shumë gjuhëve dhe kompetencave intelektuale janë gjithashtu qëllime të mëimit të gjuhës prejardhëse (gjuha e prindërve) (HSK). Për këtë arsye ky mësim mbahet në shkollat publike dhe mbështetet nga autoritetet përgjegjëse për arsimim të kantonit përkatës.

Shumëgjuhësia dhe kompetencat intelektuale

Njerëzit e rinjë, të cilët posedojnë njohuri të përgjithshme në gjuhën gjermane dhe flasin rrjedhshëm në gjuhën e prindërve të tyre, posedojnë një aftësi të rëndësishme për tu integruar në profesion dhe shoqëri

Mësimi HSK mbahet në të gjitha kantonet; në disa qytete ofrohet mësimi i më shumë se 25 gjuhëve.

Qëllimet e mëimit HSK

Fëmijët dhe të rinjtë

– i thellojnë dhe i zgjerojnë njohurit e tyre në gjuhën amtare (të parë), fitojnë më shumë kompetenca, kuptojnë më mirë në gjuhën e tyre, dhe janë në gjendje që të shkruajnë dhe lexojnë në gjuhën e tyre.

– zgjerojnë aftësit e tyre që të flasin në dy gjuhë, të njohin kulturën, vlerat e të tjerëve dhe t'i kuptojnë normat dhe të njëjtat t'i respektojnë.

Përparësit në shoqëri dhe në jetën profesionale

– ai i cili e zotëron gjuhën amtare, ka një bazë të mirë për të mësuar gjuhë të tjera.

– Njohuritë e mira në gjuhën amtare i ndihmojnë fëmijëve në ruajtjen e kontakteve familjare, me të afërmitë dhe shtetin e tyre.

– Kontakti me shtetin amë është një kompetencë e mirë dhe e rëndësishme gjuhësore për gjuhën vendore (mundësia për shkollim të mëtejshëm, punësim ose edhe rikthim në atdhe).

Prindërit mbështesin zhvillimin gjuhësor të fëmijut të tyre

– nëse ata në shtëpi flasin në gjuhën amtare me fëmijët, nëse fëmijët mendojnë dhe ëndërrojnë dhe nëse e flasin gjuhën e tyre amtare, por ata duhet të flasin edhe gjermanisht.

– nëse koleget dhe kolegët e tyre i mbështesin dhe i nxisin për të folur, duke folur dhe ndëgjuar për gjërat e jetës së përditëshme, duke ndëgjuar diskutimet, duke diskutuar, duke kënduar dhe duke treguar tregime.

– duke mbetur çdo person në familje në kontakt të drejtëpërdrejtë me fëmijun dhe duke biseduar gjithnjë e më shumë.

– duke e trimëruar fëmijun për të pasur kontakte me fëmijët tjerë, të cilët flasin gjermanisht ose ndojnë gjuhë tjetër.

– duke e lënë fëmijun të tregojë se çfarë ka mësuar në mësimin HSK.

– duke mbajtur gjithnjë kontakte me arsimtarin që u jep HSK- mësim.

Organizimi

Mësimi në gjuhën amtare (HSK) mbahet nga punëtorët e ambasadave të vendeve të tyre ose nga organizatat private. Mësimi organizohet varësisht nga grupet gjuhësore duke filluar që nga viti 1 ose 2 i mëimit parashkollor. Lajmërimi bëhet përmes shkollave publike (me përjashtim të Kantonit Bern).

Mësimi HSK zakonisht mbahet në klasa të shkollave publike, sipas mundësive në afërsi të vendbanimit të fëmijut.

Mësimi HSK bazohet sipas orarit të shkollave publike të vendeve ku banojnë fëmijët (dëftesa të mirëfillta).

Notat shënohen në dëftesë ose i bashkangjiten raportit mësimor të shkollave publike.

Adresat Kontaktuese Kantonale

Volksschulamt des Kantons Solothurn

St. Urbangasse 73
4509 Solothurn
Sachbearbeiterin HSK, Anita Falessi
anita.falessi@dbk.so.ch
032 627 63 35

Solothurn, 24. Januar 2011

Erarbeitet von den Erziehungsdepartementen und Bildungsdirektionen der Kantone Basel-Stadt, Basel-Landschaft, Aargau, Bern, Solothurn und Fribourg, in Zusammenarbeit mit den Trägerschaften des Unterrichts in heimatlicher Sprache und Kultur.